



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/03-216395/20 dt. 24.11.2020, në emër të aplikuesve Rasim Llapashtica, Bedri Llapashtica, Refki Llapashtica, Ragip Haliti, Selim Zajmi, Xhevrije Kozmaqi, Kimete Zhinipotoku, Zarije Pllana, Nurije Solçoglliu, Hafije Hyseni, Ajshe Simnica, Nexhmije Haliti Ukça, Kumrije Begisholli, Armend Zajmi, Ardiana Jashari, Levent Zajmi, Arlinda Zajmi dhe Akter Pantina nga Prishtina, dhe investitorit "ESA GROUP" shpk, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 71321061, dhe me përfaqësues/pronar Albin Hetemi, dhe të pronarit të parcelës kadastrale që do të shtohet në këtë zgjidhje urbane, Shemsi Haliti nga Prishtina, përmes së cilës kërkohet të plotësohen dhe ndryshohen kushtet e caktuara me aktin administrativ "Vendim për caktim të kushteve ndërtimore", 05 Nr. 350/02-127204/19 dt. 15.07.2019, përkatësisht të caktohen kushtet ndërtimore edhe për parcelën kadastrale nr. 6906-4 ZK Prishtinë, e shtrirë në kuadër të bllokut urban "J" të tërësisë "J", të Planit Rregullues "Dodona" në Prishtinë, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 02.03.2021 deri më 16.03.2021, në e-mail adresën: urbanizmprihtine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Kompleks me ndërtesë shumëbanesore dhe afariste, -3B+S+P+12
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	Ndërtesa është planifikuar brenda bllokut urban, është respektuar distanca në mes të ndërtesave
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	Ndërtesa është planifikuar brenda bllokut urban, është respektuar distanca në mes të ndërtesave
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=40 % ose 548.80 m ² , e propozuar ~416.80+165.16=581.86 m ² (ISHP rritet 10 % sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës, nr. 01-031-185481 dt. 18.08.2015)
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=40 % ose 548.80 m ² , e propozuar ~ 548.80 m ²
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=3.0 ose 4116 m ² , e propozuar 4116.43 m ²
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=60 % ose 823.20 m ² , e propozuar 823.20 m ²
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	50 vendparkime të brendshme
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	PO
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	PO
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MPPK nr. 09/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimi dhe leje përdorimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendoset në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shprehje dhe përgjigje njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike të dhënë më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari:

